

AKTI I THEMELIMIT

DHE

STATUTI I SHOQËRISË

“Pixel Playground” shpk

THEMELIMI

Neni 1

Ortakët themelues

- a) Elidor Lamaj, atësia Bajram, shtetas Shqiptar, identifikuar me anë të pasaportës me numër BC2452356, me numër personal identifikimi J30813059B i datëlindjes 13.08.1993, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
- b) Jurgen Lala, atësia Elez, shtetas Shqiptar, identifikuar me anë të ID me numër, me numër personal identifikimi J90809059K i datëlindjes 09.08.1999, lindur në Kavajë dhe banues në Tiranë; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

EMËRTIMI, SELIA, FORMA LIGJORE

Neni 2

Emërtimi

- 2.1 Emërtimi i shoqërisë është: **“Pixel Playground” shpk.**

Neni 3

Forma ligjore

- 3.1 Shoqëria është e formës me përgjegjësi të kufizuar dhe është themeluar në përputhje me legjislacionin tregtar në Shqipëri.
- 3.2 Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjetër në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 4

Baza ligjore

- 4.1 Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Statut, me Aktin e Themelimit, legjislationin tregtar dhe dispozita të tjera ligjore.

Neni 5

Kohëzgjatja e veprimtarisë

- 5.1 Veprimtaria e shoqërisë fillon me regjistrimin e saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit ("QKB").
- 5.2 Afati i veprimtarisë së shoqërisë është për një afat të papercaktuar.

Neni 6

Selia

- 6.1 Selia e shoqërisë është në adresën: **Bulevardi Zogu i Pare prane Maternitetit nr. Pasurie 1/204/ ND-N13 zona kadastrale nr.8360 Tirane**
- 6.2 Administratori i shoqërisë mund të vendosë të hapë degë dhe/ose filiale dhe/ose adresa sekondare dhe/ose zyra përfaqësimi të shoqërisë si brenda territorit të Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj ose mund të rregjistrojë ato ekzistuese sipas ligjeve në fuqi.
- 6.3 Shoqëria mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen në Shqipëri dhe/ose jashtë saj me vendim të Administratorit të shoqërisë.

Neni 7

Emblema. Vula

- 7.1 Shoqëria do të ketë emblemen dhe vulën e saj. Vula do të përdoret nga administratorët e shoqërisë.
- 7.2 Forma dhe përmasat e vulës do të përcaktohen në përputhje me rregullat e legjislationit shqiptar.
- 7.3 Të gjitha dokumentet e shoqërisë duhet të përmbajnë emblemen dhe vulën e saj.

Neni 8

Objekti

- 8.1 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:
1. Organizimi i eventeve e-Sports (video lojërë).
 2. Import-eksport, tregti me shumicë dhe pakicë i pajisjeve elektrike dhe elektronike.
 3. Ofrimi i shërbimeve të telekomunikacioneve.
 4. Servis, dhënie me qira dhe tregti me shumicë dhe pakicë të materialeve elektrike dhe elektronike dhe aksesoreve përkatës, si dhe materialeve elektronike, elektrike industriale.
 5. Prodhim, tregtim dhe instalim reklamash.
 6. Transport mallrash dhe personash, brenda dhe jashtë vendit.

7. Import-eksport i pajisjeve elektronike dhe elektrike inteligjente.
8. Shërbim Renderizimi me karta grafike.
9. Minimi i kriptomonedhave
- 8.2 Objekti i shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Ortakeve.

Neni 9

Kapitali

9.1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100 (një qind) Lekë dhe është i perbere nga 2(dy) kuota , qe perfaqesojne 100% te kapitalit themeltar te shoqerise. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

a)Ortaku themelues Elidor Lamaj, zotërues i 1 (nje) kuote me vlerë të përgjithshme 50 (pesedhjete) leke, që përben 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

b)Ortaku themelues Jurgen Lala, zotërues i 1 (nje) kuote me vlerë të përgjithshme 50 (pesedhjete) leke, që përben 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

9.2)Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

9.3 Kapitali është shlyer tërësisht.

Neni 10

Transferimi i kuotave. Kufizimet.

- 10.1 Kuotat mund të transferohen tek të tretët në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” me amendimet perkatese.
- 10.2 Vendosja e çfarëdolloj barre mbi kuotat në favor të palëve të treta do të lejohet vetëm me pëlqimin e Ortakeve.

Neni 11

Rritja e kapitalit

- 11.1 Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet ose zvogëlohet me vendim të Ortakeve
- 11.2 Zmadhimi i kapitalit mund të bëhet gjithashtu edhe nëpërmjet nënshkrimit dhe shlyerjes së pjesëve të tjera të kapitalit nga ortakë të rinj. Ortakët e rinj pranohen dhe miratohen si të tillë me vendim të Ortakeve.

Neni 12

Zvogëlimi i kapitalit

- 12.1 Zvogëlimi i kapitalit bëhet sipas procedurave të parashikuara nga legjislacioni tregtar.
- 12.2 Propozimi i zvogëlimit do t’i paraqitet ekspertit kontabël të autorizuar dhe administratorit të paktën 45 ditë përpara marrjes së vendimit nga Ortaket e shoqërisë.

Eksperti kontabël dhe administratori do të shqyrtojnë propozimin dhe do t'i paraqesin ortakeve raportin në lidhje me arsyet dhe kushtet e zvogëlimit të kapitalit.

- 12.3 Raporti i zvogëlimit të kapitalit do të miratohet me vendim të Ortakeve të shoqërisë.

ORGANET E SHOQËRISË

Neni 13

Vendimet e ortakeve

- 13.1 Vendimet kryesore mbi veprimtarinë e shoqërisë merren nga Ortaket e saj.

- 13.2 Vendimet e Ortakeve përfshijnë kryesisht:

- Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- Zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
- Prishjen dhe likuidimin e shoqërisë;
- Emërimin ose shkarkimin e administratorit ose administratorëve të shoqërisë si dhe përcaktimin e shpërblimit për ta;
- Emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar si dhe përcaktimin e shpërblimit për ta;
- Miratimin e bilancit të shoqërisë e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- Transformimin e shoqërisë në forma të tjera.

Neni 14

Administrimi

- 14.1 Administrimi i shoqërisë kryhet nga një administrator

- 14.2 Administratori ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë dhe drejtojë punën e përditshme të shoqërisë në përputhje me udhëzimet e Ortakeve.

Administratori i shoqërisë është z.Jurgen Lala, atësia Elez, shtetas Shqiptar, identifikuar me anë të ID me numër, me numër personal identifikimi J90809059K i datëlindjes 09.08.1999 , lindur në Kavaje dhe banues në Tirane; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar Administratori është përgjegjës për veprimtaritë e mëposhtme:

- Drejtimin e veprimtarisë së përditshme të shoqërisë;
- Përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhëniet me të tretët personalisht ose me përfaqësim;
- Hartimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve;
- Përgatitjen e dokumentave në emër të shoqërisë sipas kompetencave që zoteron;

- Të zhvillojë veprimtari të tjera të çdo lloj natyre për të mirën e shoqërisë dhe realizimin e objektit të saj;
- Të përfaqësojë shoqërinë në Shqipëri tek palët e treta, insitucione apo entitete publike ose private;
- Të lidhë për dhe në emër të shoqërisë kontrata me palë të treta;
- Të punësojë dhe pushojë punëmarrës apo staf tjetër që konsiderohet i nevojshëm për mbarëvajtjen e biznesit në Shqipëri;
- Të vendos për ndryshimin e selisë së shoqërisë;
- Të përfaqësojë shoqërinë në Shqipëri përpara bankave të nivelit të dytë dhe Bankes së Shqipërisë si dhe të kryej, në emër të shoqërisë cdo transaksion bankar në emër të shoqërisë;
- Të ndërmarrë çdo veprimtari tjetër ose biznes ose aktivitet i cili konsiderohet i nevojshëm për biznesin e shoqërisë në Shqipëri.

14.3 **Mandati i administratorit do të jetë i vlefshëm për 5 (pesë) vjet duke filluar nga sot, date 09.05.2023-09.05.2028 me të drejtë ripërtëritje ose deri në çastin e revokimit të tij me vendim të Ortakeve.**

Neni 15

Viti financiar

- 15.1 Viti financiar i shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe mbaruar më 31 Dhjetor të cdo viti.
- 15.2 Si përjashtim, viti i parë financiar i shoqërisë do të fillojë nga dita e regjistrimit të shoqërisë në Zyrën e Tatim Taksave dhe përfundon më 31 Dhjetor të po atij viti.

Neni 16

Bilanci. Kontabiliteti.

- 16.1 Bilanci vjetor i shoqërisë shqyrtohet nga Ortaket dhe duhet të përgatitet për t'u paraqitur para organeve tatimore deri në fund të muajit mars të vitit pasardhës.
- 16.2 Kontabiliteti mbahet në gjuhën dhe monedhën shqiptare si dhe sipas kërkesave të legjislacionit përkatës. Për operacione të veçanta, shoqëria mund të bëjë veprime edhe me llogari të veçanta në monedhë të huaj, duke bërë konvertimin brenda vitit.
- 16.3 Shoqëria mund të pranojë fonde nga institucionet financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë. Për këtë qëllim shoqëria mund të lërë peng pjesë të kapitalit si garanci ose mund të hipotekojë pasuritë e saj të paluajtshme, vetëm me vendim të Ortakeve.

Neni 17

Te Ardhurat. Dividendi

- 17.1 Shoqëria do të krijojë fonde rezervë për realizimin e qëllimeve të biznesit të saj në përputhje me kërkesat e ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.
- 17.2 Të ardhurat që do të rezultojnë në fund të mbylljes së cdo ushtrimori, pas pagimit të tatimeve, mund t’i kalojnë Ortakeve.
- 17.3 Humbjet e shoqërisë do të mbulohen deri në kufirin e kapitalit themeltar dhe ortaku do të përgjigjet deri në kufirin e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë. Humbjet transferohen nga mbyllja e ushtrimorit të parë deri në tre ushtrimorët vijues.

Neni 18

Likuidimi

- 18.1 Prishja e shoqërisë vendoset me vendimin te Ortakeve.
- 18.2 Me vendimin te Ortakeve caktohet një likuidator ose një grup likuidatorësh që do të plotësojnë procedurat e likuidimit.
- 18.3 Likuidatori do të përgatisë raportin e likuidimit mbi gjëndjen ekonomike të shoqërisë, rreth operacioneve të mëtejshme të likuidimit dhe kohën që nevojitet për përfundimin e tij. Në përfundim të kësaj procedure, Ortaket do të shqyrtojnë bilancin përfundimtar dhe do të miratojnë përfundimin e procedurave të likuidimit.

Neni 19

Mosmarrëveshjet

- 19.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis shoqërisë dhe të tretëve, në rast se nuk zgjidhen me mirëkuptim do t’i nënshtrohen shqyrtimit nga gjykata kompetente shqiptare.

Neni 20

Klauzolë mbyllëse


- 20.1 Ky Statut hartohet në 4 (katër) kopje me fuqi të njëjtë ligjore.

Tirane, datë 09/05/2023


ORTAKËT

E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“Pixel Playground” shpk


Jurgjen Lalo

(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)


Lidor Lomaj

(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)

LETËRNJOFTIM ID



REPUBLIKA E SHQIPERISE REPUBLIC OF ALBANIA



mbiemri/surname

Lala

emri/given name

Jurgen

shtetësia/nationality

Shqiptare/Albanian

vendlindja/place of birth

Kavajë, ALB

datëlindja/date of birth

09-08-1999

data e lëshimit/date of issue

27-11-2015

autoriteti lëshues/authority

LMPB

ALB

firma/signature

nr. letërnjoftim/card no.

032968436

gjinia/sex

M

data e skadimit/date of expiry

26-11-2025

nr. personal/personal no.

190809059K